



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

# ANALIZË

# BUXHETI I KOSOVËS 2024



27 NËNTOR 2023, PRISHTINË



## Përmbajtja

Buxheti i Kosovës ndër vite .....	2
Ndarja e buxheti të Kosovës 2024 sipas dikastereve.....	4
Ndarja e buxheti të Kosovës 2024 për investime kapitale.....	7
Grante dhe Subvencione për 2024.....	8
Grante për kompanitë e sektorit privat në Kosovës për 2024.....	9
Konkluzione dhe Rekomandime.....	11





## Buxheti i Kosovës ndër vite

Buxheti i Republikës së Kosovës, një aspekt thelbësor i administratës publike dhe forca udhëheqëse në zhvillimin ekonomik të vendit, ka ndjekur një rrugë të qëndrueshme dhe konsoliduese që nga shpallja e pavarësisë deri në vitin 2024. Kjo rrugë shënon një angazhim të vazhdueshëm të vendit për menaxhim të përgjegjshëm dhe efikas të burimeve financiare, në përputhje me synimet për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Sipas të dhënave zyrtare, pritet që buxheti për vitin 2024 të arrijë në shifrën e impresionueshme prej 3,314 miliardë Euro. Kjo shifër paraqet një rritje prej 3,2%, ose 102 milionë Euro më shumë, në krahasim me buxhetin e vitit 2023, i cili ishte 3,212 miliardë Euro. Është vërejtur se kjo rritje është e moderuar krahasuar me nivelin e inflacionit dhe nevojat e vendit për përparimin ekonomik, tregues i përpjekjeve për të ruajtur stabilitetin financiar dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.

**Figura 1: Krahasimi i buxheti të Kosovës në vitin 2023 dhe 2024 (Burimi: Ligjet për Buxhetin ndër vite)**







Figura 2, e paraqitur grafiksht, ofron një perspektivë të detajuar mbi evoluimin e buxhetit në një periudhë kohore të caktuar. Grafiku, me shfaqjen e rritjes së buxhetit nga viti në vit, krijon një perceptim të qartë të ngritjes së lehtë të konsolidimit financiar të vendit. Nga ky vizualizim grafik, bëhet e qartë se buxheti për vitin 2024 tregon një përmirësim në krahasim me vitin 2023, megjithatë, vërehet se ky përmirësim nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur shumë nevoja të kategorive të ndryshme.

Ky lloj zhvillimi pozitiv, megjithëse shënon hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të situatës financiare, nuk mund të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës. Në të njëjtën kohë, është vërejtur se ky buxhet nuk paraqet një zhvillim të dukshëm të sektorit privat. Ky fakt mund të interpretohet si një sinjal që, përkundër rritjes së buxhetit, ende ka sfida për të stimuluar sektorin privat dhe për të krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

**Figura 2: Buxheti i Kosovës ndër vite (në miliard Euro, përpos vitit 2008 në million Euro) (Burimi: Ligjet për Buxhetin ndër vite)**





## Ndarja e buxheti të Kosovës 2024 sipas dikastereve

Tabela 1 për Buxhetin Publik të Kosovës për vitin 2024 shpalos një analizë thelbësore të alokimeve financiare sipas sektorëve dhe institucioneve të përfshira. Me një shumë impulsive prej 3,314 miliardë Euro, ky buxhet ka një përqëndrim të theksuar në detajet e shpenzimeve,

duke specifikuar planin e alokimeve për secilën ministri dhe duke përfshirë në këtë proces Agjencitë, Rregullatorët, RTK, Universitetet, Akademitë, Komunat, dhe shumë të tjera. Ky dokument vizual është një burim i pasur i informacionit, duke ofruar një perspektivë të qartë dhe të strukturuar për publikun. Përmes kësaj tablele, bëhet e mundur të kuptohet me lehtësi se si planifikohen të shpenzohen burimet dhe se si çdo fushë e qeverisjes përfiton nga alokimet buxhetore. Analiza e këtij buxheti siguron një shkallë thelbësore të transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke lehtësuar njohjen dhe vlerësimin e përdorimit të fondeve publike nga ana e publikut.

Tabela 1: Buxheti i Kosovës per vitin 2023 (Burimi: Ligji për Buxhetin ndër vitin 2024)

### Buxheti i Kosovës 2024

Institucioni	Buxheti	%
Kuvendi i Kosovës	10,548,018 €	0.32%
Zyra e Presidentit	4,213,791 €	0.13%
Zyra e Kryeministrit	22,395,572 €	0.68%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	931,025,963 €	28.09%
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	89,833,563 €	2.71%
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	24,779,272 €	0.75%



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	265,445,995 €	8.01%
Ministria e Shëndetësisë	80,395,329 €	2.43%
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	174,387,768 €	5.26%
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	88,118,721 €	2.66%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	100,120,951 €	3.02%
Ministria për Komunitete dhe Kthim	6,639,660 €	0.20%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Loka	9,541,135 €	0.29%
Ministria e Ekonomisë	58,627,892 €	1.77%
Ministria e Punëve të Brendshme	216,523,467 €	6.53%
Ministria e Drejtësisë	47,041,887 €	1.42%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës	47,483,313 €	1.43%
Ministria e Mbrojtjes	153,049,911 €	4.62%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	6,889,574 €	0.21%
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	955,713 €	0.03%
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	1,672,045 €	0.05%
Autoriteti i Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	1,546,894 €	0.05%
Agjencioni Kundër-Korrupsion	965,660 €	0.03%
Zyra Rregullatorit për Energji	898,761 €	0.03%
Organi Shqyrtues i Prokurimit	502,939 €	0.02%



Univerziteti i Prishtinës	31,710,072 €	0.96%
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	1,992,123 €	0.06%
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	402,209 €	0.01%
Agjencioni Kosovar i Intelegjencës	14,249,733 €	0.43%
Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore	269,153 €	0.01%
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa	239,917 €	0.01%
Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Sherbimin Civil të Kosovës	421,794 €	0.01%
Këshilli Prokurororial i Kosovës	17,265,867 €	0.52%
Zyra Kombetare e Auditimit	3,345,655 €	0.10%
Autoriteti Rregullativ i Sherbimeve të Ujit	475,806 €	0.01%
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	423,714 €	0.01%
Autoriteti i Aviacionit Civil	687,168 €	0.02%
Komsioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	1,515,315 €	0.05%
Komisioni i Pavarur i Mediave	1,810,286 €	0.05%
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	9,874,494 €	0.30%
Institucioni i Avokatit të Popullit	1,269,018 €	0.04%
Akademia e Drejtësisë	863,245 €	0.03%
Këshilli Gjygjësor i Kosovës	35,806,910 €	1.08%
Agjencia Kosovare për krahasim dhe Verifikim të Pronës	2,613,969 €	0.08%
Agjencioni për Informim dhe Privatesi	474,049 €	0.01%
Shpenzimet e Paparashikuara	11,730,000 €	0.35%
Radio Televizioni i Kosovës	8,960,000 €	0.27%
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	8,877,671 €	0.27%




Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar	321,560 €	0.01%
Agjencioni Kosovar i Privatizimit	4,575,686 €	0.14%
Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror	9,319,409 €	0.28%
Buxheti për Komunat	742,000,000 €	22.39%
Të tjera	58,901,383 €	1.78%
<b>TOTAL BUXHETI I KOSOVËS</b>	<b>3,314 mld €</b>	<b>100.00%</b>

## Ndarja e buxheti të Kosovës 2024 për investime kapitale

Projektbuxheti për vitin 2024 në vlerë prej 3.314 miliardë eurosh, i aprovuar nga Qeveria e Kosovës, tregon një përqëndrim të theksuar në investimet kapitale, shprehur në alokimin e mbi 850 milionë eurove për projekte që synojnë të forcojnë dhe transformojnë sektorin e infrastrukturës vendore, apo 25.70% e buxhetit të përgjithshëm.

Figura 3: Buxheti për investime kapitale (Burimi: Ligjet për Buxhetin ndër vite)



Në këtë kuptim, një pjesë e rëndësishme e këtij buxheti, prej mbi 260 milionë eurosh, është destinuar për ndërtimin, asfaltimin, dhe rehabilitimin e rrugëve në të gjithë territorin e Kosovës. Kjo strategji ka për qëllim përmirësimin e lidhjeve rrugore, rritjen e sigurisë së transportit, dhe kontribuimin në rritjen ekonomike të vendit.

Megjithatë, është vërejtur se për vitin 2023, në periudhën Janar-Shtator, vetëm rreth 30% e buxhetit të paraparë për investime kapitale është shpenzuar. Ky fakt vë në dukje nevojën për një përmirësim të konsiderueshëm në efikasitetin dhe shpejtësinë e shfrytëzimit të burimeve






financiare për investime kapitale në krahasim me vitin e kaluar. Është e rëndësishme që në vitin 2024 të ketë një përdorim më të përgjegjshëm dhe të plotë të këtyre fondeve për të siguruar realizimin e projekteve thelbësore për zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve jetësore për qytetarët e Kosovës. Kjo do të shërbejë jo vetëm për avancimin e sektorit infrastrukturor, por edhe për të thelluar stabilitetin financiar dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

## Grante dhe Subvencione për 2024

Në vitin 2024, shuma e subvencioneve do të jetë mbi 1 miliard euro, duke paraqitur një pjesë të konsiderueshme të buxhetit vjetor, ndërsa praktikisht arrin të jetë thjeshtë 1/3 e tij apo 33%. Kjo ngritje e rëndësishme është ndaj gjendjes së vështirë në të cilën ndodhen shumë kategori dhe sektorë ekonomikë. Skemat e subvencioneve të përgatitura për kategoritë e ndryshme kanë një karakter thelbësor që synon të mbështesë dhe të sigurojë mbijetesën e këtyre sektorëve ekonomikë dhe kategorive sociale, duke përcaktuar një përqendrim të veçantë në nevojat e tyre aktuale.

**Figura 4: Vlera për subvencione për 2024 (Burimi: Thirrjet e hapura gjatë vitit 2024)**





## Grante për kompanitë e sektorit privat në Kosovës për 2024

Grante për kompanitë e sektorit privat në Kosovë për vitin 2024 duket se kanë mbetur thuajse të pandryshuara në krahasim me ato të vitit paraprak. Në përgjithësi, dikastere të ndryshme, si Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/KIESA, dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, zakonisht zhvillojnë thirrje për biznese, NVM-te dhe Start Up-e për të aplikuar për grante.

**Figura 5: Vlera për grante për kompanitë e sektorit privat në Kosovës për 2024 (Burimi: Thirrjet e hapura gjatë vitit 2023)**




Figura 4, e paraqitur grafiksht, ofron një perspektivë të detajuar mbi shumën e ndar për grante sipas Ministrive. Në këtë kuptim:


- ✓ **Ministria e Zhvillimit Rajonal:** Alokim: 1 milion Euro për NVM dhe Start Up.
- ✓ **Ministria e Bujqësisë:** Alokim: 25 milion Euro për kompanitë përpunuese të produkteve bujqësore dhe fermer sipas masave të caktuara.
- ✓ **Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/KIESA:** Alokim: 1 milion Euro për NVM-te dhe kryesisht për kompanitë prodhuese.
- ✓ **Ministria për Komunitete dhe Kthim:** Alokim: 1 milion Euro për NVM dhe Start Up me bazë në komunitet.



- ✓ **Të tjera:** Grante të tjera të vogla të cilat mund të jenë të gjitha bashkë prej të gjitha Ministrive të tjera.

Vlera e përgjithshme e granteve për vitin 2024 parashikohet të jetë rreth 30 milion euro. Këto grante janë të përqendruara veçanërisht në avancimin e kapacitetit prodhues të NVM-ve dhe në ndihmën për hapjen e start-up-ave. Megjithëse shuma absolute është rreth 1% e buxhetit të përgjithshëm. Kjo përqindje tregon përpjekjen e pakët për të inkurajuar dhe zhvilluar sektorin privat, dhe duke mos përshtatur ndihmën financiare me kujdes sipas nevojave dhe potencialeve të tyre.

**Figura 6: Vlera për grante për kompanitë e sektorit privat në Kosovës për 2024 (Burimi: Thirrjet e hapura gjatë vitit 2023)**



Megjithatë, kjo mbështetje për sektorin privat për vitin 2024 duket të jetë në masë relativisht e vogël dhe nuk shfaq ndryshime të konsiderueshme nga viti paraprak. Këto grante janë kryesisht të përqendruar në nxitjen e zgjerimit të kapaciteteve prodhuese, stimulimin e eksportit, dhe zëvendësimin e importeve të caktuara.

Grantet apo subvencionet që do të jepen për sektorin privat janë edhe ato të formatit të subvencionimit në pagë dhe praktikë profesionale për nxitje të punesimit, subvencionimi i kulturave të ndryshme bujqesore, standardizime të caktuara të produkteve, etj. Nuk janë të paraqitura në grafikonin më lartë për faktin sepse nuk i përkasin kategorisë së ndihmës në rritje të kapacitetit prodhues.

Megjithatë, është vlerësuar se ky mbështetje për sektorin privat për vitin 2024 duket të jetë në masë relativisht të vogël dhe nuk shfaq ndryshime të konsiderueshme nga viti paraprak.



## Konkluzione dhe Rekomandime

- ✓ **Buxheti i planifikuar për vitin 2024 do të jetë 3,314 miliardë Euro:**
  - Një rritje të qëndrueshme, prej 102 milionë Eurosh ose 3.2%, në krahasim me vitin paraprak.
- ✓ **Grante për Zhvillim të NVM-ve dhe Start-up-e:**
  - Vlera e përgjithshme e granteve për vitin 2024 është rreth 30 milion euro apo vetëm rreth 1% e buxhetit të përgjithshëm.
- ✓ **Subvencione për Vitin 2024:**
  - Vlera e subvencioneve për 2024 pritet të jetë mbi 1 miliard euro, apo rreth 33% e buxhetit të përgjithshëm.
- ✓ **Buxheti për investime kapitale:**
  - Buxheti për investime kapitale parashikohet të jetë 850 milion euro, apo rreth 25.70% të buxhetit të përgjithshëm.
- ✓ **Rritje e investimeve kapitale:**
  - Është e rëndësishme të sigurohet realizimi i investimeve të parapara, sidomos në fushën e investimeve kapitale, pasi kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e sektorëve të ndryshëm.
- ✓ **Fokusi në sektorin privat dhe sektorin e prodhimit në veçanti :**
  - Duhet të kihet një përqendrim i veçantë në sektorin privat, me theks të posaçëm në sektorin e prodhimit. Ky përqendrim mund të përfshijë politika dhe masa që inkurajojnë rritjen e aftësive prodhuese dhe konkurrueshmërisë në treg.
- ✓ **Promovimi i Eksportit:**
  - Është e nevojshme të promovohet dhe nxitet eksporti në vitin 2024, duke pasur parasysh rënie të eksportit gjatë vitit 2023. Për këtë, mund të zhvillohen politika dhe masa të veçanta për të përmirësuar performancën eksportuese të vendit.
- ✓ **Eliminimi i Barrierave Burokratike:**
  - Mekanizmat për eliminimin e barrierave byrokratike dhe të tjera që pengojnë kompanitë duhet të jenë në qendër të vëmendjes. Kjo përfshin një përmirësim të klimës biznesore dhe një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e aktiviteteve të biznesit.
  -



✓ **Rritja e Investimeve të Huaja dhe**

- Qeveria duhet të përqendrohet në rritjen e investimeve të huaja në Kosovë .

✓ **Bashkëpunimi në Arsimit Dual – Kompani – Institucion Arsimor**

- Qeveria duhet të zhvillojë mekanizma për të ndihmuar lidhjen e bashkëpunimit midis kompanive dhe institucioneve arsimore. Kjo përfshin përkrahjen për implementimin e arsimit dual dhe mesimit në vendin e punës, duke krijuar një rrjet të fortë midis sektorit privat dhe sistemit arsimor.





ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

**Departmenti për Analiza dhe Kounikim Strategik**



**Rr. Nëna Terezë, Nr. 20**  
**10000 Prishtinë, Republika e Kosovës**  
**[info@oek-kcc.org](mailto:info@oek-kcc.org), [www.oek-kcc.org](http://www.oek-kcc.org)**